



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 2-180/6479  
Nr. i faq. 77  
Data 12/10/2020

german  
cooperation  
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT



**PLANI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE**  
**KOMUNA E JUNIKUT**  
**2020-2025**



## **FJALA E KRYETARIT**

*Të nderuar qytetarë të Komunës së Junikut!*

*Komuna e Junikut është një kumunë me një sipërfaqe shumë të vogël, por që në vashdimësi ka treguar përkushtim dhe vëmendje në çështjet e mbajtjes pastër të ambientit. Prioritetet dhe nevojat, me kalimin e viteve, kanë ndryshuar dhe kanë avancuar dukshëm. Më i rëndësishmi në fazën që jemi është edhe mbrojtja e ambientit ku jetojmë. Ambienti i pastër është sfidë më vete që mund të realizohet, duke bashkëpunuar me qytetarët dhe duke bashkërenditur aktivitetet me faktorët e ndryshëm dhe relevantë në fushën e mbrojtjes së ambientit.*

*Në fazën në të cilën jemi, gjendja në fushën e mbrojtjes së ambientit dhe menaxhimit të mbeturinave është në nivelin e duhur, mirëpo ne kemi synime dhe objektiva edhe më të mëdha. Kjo paraqet për ne një sfidë të rëndësishme dhe aktuale, e cila kërkon të përfshijë shumë faktorë në realizimin e objektivave tona për trajtim e përshtatshëm të mbeturinave dhe rrjedhimisht për krijimin e një ambient të pastër. Bashkëpunimi dhe vetëdijësimi për këtë çështje është faktor kyç dhe i pa zëvendësueshëm.*

*Hartimi dhe miratimi i një Plani për menaxhimin e mbeturinave është më shumë se i mirëseardhur, pasi përbën edhe një bazë tjetër që përcakton detajshëm mënyrën e realizimit të tij dhe objektivave të parapara bashkë me dinamikën e realizimit të tij. Ky dokument është një fazë e re e trajtimit të mbeturinave në nivel të Komunës së Junikut dhe zbatimi i tij do të rrisë vetëdijen e qytetarëve për ambient të pastër, shoqëruar me trajtimin të përshtatshëm dhe profesional të tyre. Plani ka përshkruar gjendjen faktike të menaxhimit të mbeturinave, duke përcaktuar edhe objektivat e realizueshme, me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë të kësaj fushe, ndihma dhe përkrahja e të cilëve ka rëndësi të veçantë. Falenderim të veçantë për hartimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave të Komunës së Junikut shkojnë për Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim GIZ, EcoDES, STUDIO, CEAE dhe Grupin punues të hartimit të këtij dokumenti.*

*Të nderuar qytetarë, ne po krijojmë një dokument të rëndësishëm, që për synim ka menaxhimin e mbeturinave dhe si rrjedhojë edhe krijimin e ambientit të pastër. Qëllimi parësor dhe i përbashkët i yni është mbrojtja e ambientit ku ne jetojmë dhe kryejmë aktivitetin e përditshëm, i cili duhet të përkthehet si një obligim për secilin qytetar të Komunës së Junikut!*

*Kryetari i Komunës së Junikut*

*Z. Agron Kuçi*

## *Falenderim për palët e përfshira në hartimin e PLMM*

*Një falenderim i veçantë shkon për stafin e GIZ Kosovë Zj. Drita BINAJ, Zj. Vjollca BEHLULI, Z. Kemal HADZAGIC, dhe për stafin e asistencës teknike të EcoDES Studio Z. Konalsi GJOKA, Zj. Teida SHEHI, Z. Alfred LAKO Zj. Keida YMERAJ dhe stafin e CEAE (Qendra për Mjedis dhe Energji Alternative) Z. Arben NIKA dhe Z. Tahir KRASNIQI që kontribuan dhe asistuan Komunën e Junikut për hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.*

*Me përkushtim të madh punuan për hartimin e planit edhe grupi punues i Komunës Junikut Z. Hysen IMERI, Zj. Kosovare GACAFERI, Z. Rrustem PEPSHI, Zj. Blerina SALLAJ, Z. Turim GANIJAJ, Z. Artan KRASNIQI, Z. Shpejtim KUÇI, Z. Arten HAMZA, Z. Isuf BALAJ, Z. Din MALOKU dhe Kompanin VB Tofaj për ofrimin e të dhënave.*

*Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për bashkëpunimin dhe mbështetjen e kryetarit të Komunës së Juniks Z. Agron KUÇI.*

## TABELA PËRMBAJTJES

<b>I.</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
1.1	INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI KOMUNËN.....	8
1.1.1	<i>Të dhëna demografike</i> .....	9
<b>II.</b>	<b>ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE</b> .....	<b>11</b>
2.1	INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI LEGJISLACIONIN.....	11
2.1.1	<i>Instrumentat dhe mjetet në nivel vendor</i> .....	11
2.1.2	<i>Struktura organizative në komunë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave</i> .....	12
2.1.3	<i>Qeveria qendrore</i> .....	13
2.1.4	<i>Pushteti lokal</i> .....	14
2.1.5	<i>Kompanitë rajonale të menaxhimit të mbeturinave</i> .....	14
2.1.6	<i>Kompanitë e tjera</i> .....	14
<b>III.</b>	<b>ASPEKTEVE TEKNIKE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE</b> .....	<b>15</b>
3.1	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI MBETURINAT.....	15
3.1.1	<i>Sasia e prodhuar e mbeturinave</i> .....	15
3.1.2	<i>Përbërja e fraksioneve të mbeturinave</i> .....	15
3.1.3	<i>Trendi i prodhimit të mbeturinave në komunë</i> .....	17
3.2	SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE.....	18
3.3	TRAJTIMI DHE ASGJESIMI I MBETURINAVE.....	21
3.3.1	<i>Riciklimi dhe kompostimi</i> .....	21
3.3.2	<i>Deponia</i> .....	21
3.3.3	<i>Pastrimi i deponive ilegale në Komunë e e Junikut</i> .....	23
<b>IV.</b>	<b>ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE</b> .....	<b>25</b>
4.1	KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE.....	25
4.2	KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE.....	26
<b>V.</b>	<b>PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE</b> .....	<b>27</b>
5.1	OBJEKTIVAT DHE TARGETAT E STRATEGJISE DHE PLANIT NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.....	27
5.2	OBJEKTIVAT E LIGJIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.....	29
5.3	VIZIONI I PLANIT KOMUNAL.....	30
5.4	OBJEKTI I PLANIT.....	31
<b>VI.</b>	<b>HARTIMI DHE PERSHKRIMI I MASAVE PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT</b> .....	<b>33</b>
6.1	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN I TË PLANIT</i> .....	33
6.1.1	<i>Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbeturinave</i> .....	34
6.1.2	<i>Konsolidimi i stukturës brenda komunës</i> .....	34
6.1.3	<i>Ngritja e kapaciteteve brenda komunës</i> .....	36
6.1.4	<i>Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit</i> .....	36
6.2	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN II TË PLANIT</i> .....	39
6.3	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN III TË PLANIT</i> .....	42
6.4	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN IV TË PLANIT</i> .....	46
6.4.1	<i>Forcimi i kapaciteteve për inkasimin e tarifës</i> .....	46
6.5	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN V TË PLANIT</i> .....	51
6.6	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN VI TË PLANIT</i> .....	57
6.7	AKTIVITETET KRYESORE PËR TË PËRMBUSHUR <i>OBJEKTIVIN VII TË PLANIT</i> .....	58
6.7.1	<i>Menaxhimi i mbeturinave medicinale</i> .....	59

6.7.2	<i>Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi (Prioritet)</i> .....	59
6.7.3	<i>Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura</i> .....	59
6.7.4	<i>Menaxhimi i mbeturinave nga kafshët</i> .....	60
<b>VII.</b>	<b>HARTIMI I PLANIT OPERACIONAL, OBJEKTIVAT, INDIKATORET DHE AKTIVITETET</b> .....	<b>61</b>
<b>VIII.</b>	<b>RISHIKIMI I PLANIT</b> .....	<b>73</b>
8.1	MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT .....	73
8.2	RAPORTIMI .....	74
<b>IX.</b>	<b>REFERENCAT E PLANIT</b> .....	<b>76</b>

## Lista e Figurave

Figura 1 Pozita gjeografike e Komunës së Junikut .....	8
Figura 2 Struktura organizative e Komunës Junik .....	12
Figura 3 Sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë dy viteve në secilin muaj.....	15
Figura 4 Përqindja e fraksioneve të mbeturinavenë nivel Kombëtar .....	16
Figura 5 Trendi i rritjes së popullsisës dhe sasisë së mbeturinave gjatë 10 viteve të ardhshme .....	18
Figura 6 Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Junikut.....	20
Figura 7 Deponi legale për mbeturinat nga ndërtim demolimi në Komunën Junik.....	22
Figura 8 Deponitë ilegale në Komunën Junik .....	23
Figura 9 Lloji i mbeturinave në deponitë ilegale në territorin e Komunës .....	24
Figura 10 Sipërfaqja e deponive ilegale në territorin e Komunës.....	24
Figura 11 Sasia e qeseve në deponitë ilegale.....	25
Figura 12 Kosto e plotë e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave .....	26
Figura 13 Procesi i diskutimeve me grupin e punës për hartimin e planit.....	30
Figura 14 Objektivat e planit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën Junik .....	31
Figura 15 Skema e rrymës të mbeturinave komunale .....	32
Figura 16 Aktivitetet e Objektivit I .....	34
Figura 17 Detyrat e programit të parandalimit të mbeturinave .....	38
Figura 18 Kategoritë e Strategjisë për parandalimin e mbeturinave .....	38
Figura 19 Shporta 120 litra.....	41
Figura 20 Sasia e mbeturinave të riciklueshme që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave .....	43
Figura 21 Sasia e mbeturinave organike që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave.....	44
Figura 22 Komposter për mbeturinat organike.....	44
Figura 23 Opsionet e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave...48	
Figura 24 Përshkrimi i opsioneve të mbulimit të kostos .....	49
Figura 25 Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos .....	49
Figura 26 Strategjia për inkasimin e tarifave.....	50
Figura 27 Indikatorët e performancës.....	74
Figura 28 Struktura e rishikimit të planit.....	75

## Lista e Tabelave

Tabela 1 Popullsia sipas moshës dhe gjinisë .....	10
Tabela 2 Të dhëna demografike për Komunën e Junikut.....	10
Tabela 3 Treguesit e mbeturinave komunale në Junik.....	17
Tabela 4 Situata e klientëve në Komunën e Junikut .....	18
Tabela 5 Infrastruktura me kontenierë për grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Junikut.....	19
Tabela 6 Niveli i tarifave të pastrimit sipas kategorive të konsumatorëve .....	27
Tabela 7 Kosto e operative e personelit për kompaninë komunale “Moronica” .....	35
Tabela 8 Përmbledhja e kostove për konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave.....	39
Tabela 9 Përmbledhja e kostove për investimet për konsolidimin dhe zgjerimin e shërbimit.....	42

Tabela 10 Projektioni i gjenerimit të mbeturinave dhe minimizimit të tyre gjatë 5 viteve të ardhshme .....	43
Tabela 11 Kosto e investimit për minimizimin e mbeturinave .....	46

## I. HYRJE

### 1.1 Informacion i përgjithshëm mbi komunën

Komuna e Junikut ka një sipërfaqe prej 77,77 km<sup>2</sup>, prej të cilave zona urbane e qytetit të Junikut është 520 ha (5,2 km<sup>2</sup>). Zona urbane është vendosur në një lartësi mbidetare prej 450m deri 600m.

Komuna e Junikut si pozicion gjeografik gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës në veri-perëndim të luginës së Dukagjinit.

Ajo kufizohet me:

- ❖ Komunat e Deçanit dhe Gjakovës
- ❖ Republikën e Shqipërisë
- ❖ Republikën e Malit të Zi.

Për më tepër, Juniku është i rrethuar nga vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna, të cilat ofrojnë një mundësi ideale për zhvillimin e turizmit malor me peizazh piktoresk, të pasur me florë dhe faunë, masivë të kanionëve piktoreske dhe kullotat shkëmbore në majat më të larta në Kosovë, majat e Bjeshkëve të Nemuna.

Komuna e Junikut, përveç qytetit të Junikut, përbëhet nga dy fshatra të cilët tanimë janë braktisur në masë të madhe: Jasiq dhe Gjocaj.




Figura 1 Pozita gjeografike e Komunës së Junikut

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Zona urbane e Junikut ka sipërfaqe prej 520 ha dhe ndodhet në terren me pjerrësi të vogël, e cila ndërpritet nga përrenj të vegjël (jaze) që e sjellin ujin nga lartësitë dhe e shpërndajnë në fushë. Si elemente identifikuese të zonës urbane janë lumenjtë "Erenik" dhe "Travë". Nga ana jug-lindore ky element vjen dhe zgjerohet në formën e një hinke, formë të cilën e thekson edhe më shumë relievi kodrinor i përbërë nga kodrat periferike të Moronicës dhe Rogoçit.

Korridoret dominuese rrugore në Komunën e Junikut janë rrugët regjionale, të cilat lidhin Junikun me qendrat më të afërta si Deçani, Peja dhe Junik. Gjendja fizike e këtyre akseve është relativisht e mirë, dhe përmes tyre përballohet ngarkesa e trafikut të shkallës së mesme.

Qasja në Junik arrihet nëpërmjet këtyre katër rrugëve kryesore:

- Lidhja me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë, rrugë regjionale 5,5 km (deri në udhëkryqin e Rastavicës)
- Lidhja me Gjakovë/Shqipëri nëpër Ponoshec, 2,3 km në territor të Junikut (deri te Batusha)
- Lidhja me Gjakovë nëpër Dobrosh, rrugë komunale, 3,5 km në territor të Junikut
- Lidhja me Deçan nëpër Voksh, rrugë regjionale, 2 km në territor të Junikut). Të gjitha lidhjet janë rinovuar rishtas (mbulojë e re asfalti në të gjitha lidhjet dhe disa rikonstruksione të kryera në lidhjen e Deçanit) dhe janë në gjendje të mirë dhe shërbejnë për nevojat e transportit aktual. Megjithatë disa prej çështjeve që duhet të drejtohen janë:
  - Lidhja me magjistralen Pejë-Gjakovë është e orientuar në drejtim të Deçanit. Si karakteristikë e saj është një shpat i pjerrët që kalon nëpër lagjen Gaxherr. Një lidhje tjetër duke përdorur rrugën/shtegun komunal që lidh Hotelin Oda e Junikut me rrugën regjionale do të jetë i favorshëm për transport mallrash me shpate më të buta. Kjo gjithashtu do të sigurojë një lidhje të shkurtër për në Junik (kjo lidhje do të shtrihet pjesërisht në territorin e Deçanit, e cila është gjithashtu dhe kryesisht me rëndësi strategjike për Junikun).
  - Lidhja me Deçanin përmes Vokshit që kalon afër fshatit Dranoc. Rruga që lidh është praktike për të gjitha automjetet e terrenit. Dranoci është një zonë e rëndësishme e trashëgimisë dhe ka nevojë të jetë i lidhur në funksion të zhvillimit të një qasje ndërkomunale të trashëgimisë dhe të turizmit natyror (lidhja do të shtrihet në territorin e Deçanit e cila është gjithashtu me rëndësi strategjike për Junikun).
- Lidhja direkte me Shqipërinë nëpërmjet rrugëve malore duke shfrytëzuar ish bazën ushtarake e cila ekziston. Është praktike për të gjitha automjetet e terrenit përtej sektorëve të gjata. Ajo mund të zhvillohet si pjesë e programit të qasjes pyjore/malore dhe të bashkëpunimit ndërkufitar.
- Ekzistojnë gjithashtu edhe rrugët sezonale, të cilat shfrytëzohen për bujqësi dhe meqë këto rrugë ndodhen në pronësi private kjo paraqet një problem në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

#### 1.1.1 Të dhëna demografike

Lëvizjet demografike në Komunën e Junikut nuk dallojnë shumë nga trendet mesatare në nivel të Kosovës. Në regjistrimin e fundit të popullsisë të bërë në Republikën e Kosovës rezulton se Komuna e Junikut ka 6,084 banorë dhe rreth 1,141 ekonomi familjare. Nga viti 2011 numri i popullsisë dhe i ekonomive familjare ka pësuar një rritje (viti 2011: 6,069 banorë dhe 770 ekonomi familjare). Ky regjistrim nuk përfshinë banorët të cilët kanë emigruar, bashkë me të cilët Komuna e Junikut rezulton të ketë një numër prej 9,500 banorësh.

Komuna e Junikut përbëhet nga tre vendbanime:

- ❖ Qyteza e Junikut
- ❖ Fshati Gjocaj
- ❖ Fshati Jasiq

Në dy fshatrat e Komunës së Junikut, Gjocaj dhe Jasiq, së bashku banojnë më pak se 10 familje dhe praktikisht e gjithë popullsia e komunës është e përqendruar në qytetin e Junikut. Kryesisht ka shtëpi të dyta që përdoren për pushim, kullotje apo aktivitete sezonale në zonën e Bjeshkëve të Nemuna duke shkaktuar vështirësi të konsiderueshme në menaxhimin e mbeturinave në zonat jashtë qendrës së qytetit.

Popullsia sipas moshës dhe gjinisë											
1-7		8-18		19-25		26-40		41-46		>65	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7.06%	6.54%	9.92%	10.46%	8.48%	7.71%	12.70%	11.67%	8.60%	8.95%	2.98%	4.93%
13.60%		20.38%		16.19%		24.37%		17.55%		7.91%	

Tabela 1 Popullsia sipas moshës dhe gjinisë

[Burimi: Komuna Junikut]

Në tabelën më poshtë jepet numri i amvisërive, bizneseve dhe institucioneve në Komunën Junik:

<b>Numri i amvisërive</b>	<b>1,141</b>
<b>Numri i bizneseve</b>	<b>121</b>
<b>Numri total i institucioneve</b>	8 (2 shkolla, Komuna, 1 Qendër Kryesore për Mjekësi Familjare, 1 Qendër turizimi, QPS, Biblioteka, Muzeu)
<b>Numri i tregjeve të gjelbërta</b>	<b>1</b>
<b>Numri i fermave lektorale dhe prodhimtarisë të kulturave bimore</b>	Mbi 50 fermerë të vegjël dhe 66 fermerë plotësojnë kriteret për subvencione

Tabela 2 Të dhëna demografike për Komunën e Junikut

[Burimi: Komuna, Kompania „VB-TOFAJ“]

Trendi dhe prognoza demografike: Duke marrë parasysh që Komuna e Junikut është një komunë e vogël ajo paraqitet mjaft delikate ndaj ndryshimeve ekonomike apo atyre demografike. Pavarësisht mungesës së informacioneve zyrtare, mund të themi se Juniku është vendbanim në zhvillim dhe me tendencë për t'u ndërtuar, prandaj është i domosdoshëm kontrolli dhe udhëzimi për këtë zhvillim. Parashikimi demografik është bazuar në llogaritjen e shkallës së shtimit të popullsisë në nivelin e Kosovës (e cila sipas statistikave të nxjerra nga Enti Statistikor është rreth 1.4%). Sipas këtij trendi, Juniku pritet që në vitin 2023 të ketë rreth 11,000 banorë (nëse merret e dhëna zyrtare prej 9,600 banorëve përfshirë diasporën). Duke ditur që të dhënat në terren dhe ato nga Entit të Statistikave të Kosovës tregojnë një situatë ndryshe: numri i banorëve rezident në Junik (sipas të dhënave të ESK) deri në 2023 pritet të jetë rreth 6,600 banorë (pra pa diasporën).

## II. ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### 2.1 Informacion përmbledhës mbi legjislacionin

#### 2.1.1 Instrumentat dhe mjetet në nivel vendor

Kuadri ligjor për Republikën e Kosovës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave përbëhet nga kjo kornizë ligjore me specifikimet përkatëse:

**Ligji nr. 03/I-040 “Për vetqeverisjen lokale”, 2008** - Në nenin 17 të këtij ligji përcaktohet që aktorët lokalë (Komunat) kanë kompetencë të plotë dhe ekskluzive për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, siç është ai i menaxhimit të mbeturinave.

**Ligji nr. 04/I-060 “Për menaxhimin e mbeturinave”, 2012** – ky ligj, i cili është i amenduar rishtazi, paraqet bazën ligjore për përcaktimin e kompetencave komunale në Republikën e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave. Sipas këtij ligji komunat duhet të: i) hartojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional; ii) të zbatojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave; iii) përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale; iv) sipas ligjit dy ose më shumë komuna mund të bashkëpunojnë për menaxhimin e mbeturinave.

Sipas ligjit këto plane komunale duhet të fokusohen kryesisht tek: i) skemat/ programi për mbledhjen e mbeturinave; ii) propozimet për teknikat e duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave; iii) programin për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave; iv) vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji përcakton që plani komunal do të hartohet për një periudhë 5 vjeçare dhe do të adresojë kapacitetet ekzistuese dhe ato në të ardhmen për mbledhjen e mbeturinave, trajtimin dhe deponimin e tyre, ku do të përcaktohet edhe nevoja për veprim për shërbimin cilësor ndaj qytetarëve, si dhe draftimin e një rregullore komunale të menaxhimit të mbeturinave

Gjithashtu sipas ligjit të amenduar, menaxhimi i mbeturinave komunale nga komunat duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një ose më shumë operator publik ose privat të licensuar<sup>1</sup> për administrimin e mbeturinave.

**Ligji nr. 04/I-111 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të ndërmarrjeve publike”, 2012** – Sipas këtij ligji Komunat kanë të drejtë të krijojnë ndërmarrje publike komunale për menaxhimin e mbeturinave.

**Ligji nr. 04/I-045 “Për partneritetin publiko-privat** – dispozitat e këtij ligji rregullojnë ofrimin e shërbimeve publike dhe /ose infrastrukturën publike për menaxhimin e mbeturinave, ku përfshihet mbledhja, deponimi, dhe riciklimi i tyre.

Në Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave<sup>2</sup> përcaktohet kjo strukturë e aktorëve kryesorë të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e tyre duke filluar nga pushteti qendror tek ai lokal dhe sektori privat:

<sup>1</sup>Licencën për menaxhimin e mbeturinave e lëshon Ministria e Infrastrukturës, respektivisht Komisioni i Licensimit

<sup>2</sup>Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e Mbeturinave 2013-2020

## 2.1.2 Struktura organizative në komunë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

Juniku është një nga komunat më të reja të Kosovës, e certifikuar si komunë në gusht 2008. Zgjedhjet e Nëntorit 2009, shënuan zgjedhjet e para lokale të mbajtura ndonjëherë në këtë komunë. Administrata aktuale komunale përbëhet nga zyra e kryetarit dhe shtatë drejtorive komunale me sektorët e tyre dhe drejtorët e emëruar nga kryetari.




Figura 2 Struktura organizative e Komunës Junik

[Burimi: Komuna e Junikut, <https://kk.rks-gov.net/junik/organogrami/>]

Ndërkohë drejtori të tjera në komunë kanë disa funksione të caktuara të cilat lidhen me aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike, si përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha shërbimeve në pronat publike dhe komunale, është përgjegjëse për të monitoruar punët e kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave të tjera komunale, ku

ndër to janë edhe kompanitë për menaxhimin e mbeturinave komunale, të kontraktuara nga komuna.

- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimit dhe mënyrën e vjeljes së saj.
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, është përgjegjëse për hartimin e rregullores lokale për kontrollin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës, si dhe siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.
- Drejtoria për Punë Inspektuese e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë, si dhe dhe task forca për zbatimin e gjobave mandatore kundrejt atyre që nuk zbatojnë ligjin.

Komuna e shikon si shumë të nevojshme, nisur edhe nga detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore që ia ngarkon kuadri ligjor, të ngrihet një sektor i veçantë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave në varësi të kësaj drejtorie. Sektori do të jetë i dedikuar plotësisht sistemit të menaxhimit të mbeturinave, duke ndjekur hap pas hapi zbatimin e planit dhe monitorimin e vazhdueshëm të kompanive publike dhe private për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

Ndonëse kuadri ligjor i delegon të drejta komunës në lidhje me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, mungesa e një sektori për menaxhim të mbeturinave ka çuar në një situatë, ku cilësia e shërbimit të ofruar nga kompania nuk është gjithmonë në standardin e kërkuar, si pasojë e mos kontrollit dhe monitorimit rigoroz nga komuna.

### 2.1.3 Qeveria qendrore

**Kuvendi i Republikës së Kosovës**, si organi legjislativ i vendit, është përgjegjës për pjesën e miratimit të ligjeve, në këtë rast në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga komisionet ligjore. Më konkretisht ai është përgjegjës për: i) miratimin e ligjit për mjedisin, ligjit për mbeturinat dhe kuadrin ligjor relevant për fushën përkatëse; ii) nxjerrjen e strategjive për hmbrojtjen e mjedisit; iii) dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit.

**Qeveria e Republikës së Kosovës**, është organi përgjegjës për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve administrative qeveritare.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit** është organi, i cili propozon, harton dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbeturinave. *Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit* pranë kësaj ministrie, është organi përgjegjës për aspektet e politikës kombëtare dhe kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Konkretisht detyrat e këtij departamenti janë:

- Propozon, harton dhe siguron bazën për krijimin e politikave për mbrojtjen së mjedisit;
- Harton dokumente Strategjike dhe legjisacionin për fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Propozon masa dhe projekte për rehabilitimin e zonave të "nxehta";
- Përcakton dhe propozon investimet dhe financimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen aktivitete administrative dhe profesionale për anëtarësim në Konventa, Traktate, Marrëveshje dhe Organizata ndërkombëtare, për mbrojtjen e mjedisit;

- Ofron mbështetje profesionale, për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Shqyrton dhe përgatit propozim vendim për kërkesat e palëve, për çështje të ndryshme mjedisore;
- Përgatit raporte të ndryshme për çështje mjedisore

#### 2.1.4 Pushteti lokal

Pushteti lokal, ose organi ekzekutiv në nivel lokal (**Komuna**), është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës lokale për menaxhimin e mbeturinave, cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të mbeturinave. Konkretisht ato janë përgjegjëse për:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapsinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbeturinave.

#### 2.1.5 Kompanitë rajonale të menaxhimit të mbeturinave

Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

#### 2.1.6 Kompanitë e tjera

Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

**Kompanitë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – KMDK** –Këto kompani janë kompani shtetërore dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunave.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e legalizuar dhe e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

**Kompanitë e licensuara**, apo sektori privat, janë kompani të cilat licensohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

**Roli i komunës në menaxhimin e mbeturinave:** Në komunë struktura organizative për menaxhimin e mbeturinave është e organizuar në këtë mënyrë: Drejtoria e Shërbimeve publike është përgjegjëse për të gjitha proceset për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Njëkohësisht në komunë është edhe struktura e Inspeksionet si dhe task forca për zbatimin e gjobave mandatore kundrejt atyre që nuk zbatojnë ligjin. Gjithashtu komuna ka si detyrë edhe aktivitete dytësore në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (hapsirat e gjelbërta, fshirjen e rrugëve etj), nga ku 12,000 ml trotuar dhe rrugë pastrohen nga kompania e pastrimit.

### III. ASPEKTEVE TEKNIKE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

#### 3.1 Të dhëna të përgjithshme mbi mbeturinat

##### 3.1.1 Sasia e prodhuar e mbeturinave

Shërbimi i grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave në deponinë regjionale në Pejë, ofrohet nga Kompania Private për Mbeturina “ VB Tofaj” e cila është kontraktuar sipas procedurave të prokurimit. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga amvisëritë dhe bizneset me përjashtim të institucioneve publike. Në grafikun më poshtë tregohet sasia e mbeturinave të grumbulluara/deponuara gjatë dy viteve të fundit:




Figura 3 Sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë dy viteve në secilin muaj  
[Burimi: “VB TOFAJ”]

Siç mund ta shohim nga grafiku sasia e mbeturinave që është grumbulluara në vitin 2019 ka pësuar një rritje, në krahasim me sasinë e mbeturinave të grumbulluara gjatë vitit 2018, edhe pse frekuenca e grumbullimit të mbeturinave është përgjysmuar nga viti në vit.

##### 3.1.2 Përbërja e fraksioneve të mbeturinave

Deri tani nuk është kryer ndonjë hulumtim në Komunën e Juniks në lidhje me përbërjen mercollogjike të mbeturinave. Në vitin 2011 GIZ<sup>3</sup> në Kosovë ka kryer studim për përbërjen e fraksioneve të mbeturinave dhe në nivel kombëtar mbeturinat organike përbëjnë **43%** të rrymës së mbeturinave.

<sup>3</sup>GIZ, Analysis of Municipal Waste Prishtina – Kosovo, 2011

Ndërsa fraksione të tjera të mbeturinave si lënda drusore, letra, plastika, qelqi, metalet, materialet e përbëra, tekstilet, mbeturinat EEE, si dhe kategori të tjera të papërcaktuara përbëjnë rreth **37%** të përbërjes së mbeturinave. Pjesa tjetër e fraksioneve të mbeturinave janë fraksione të parikuperueshme si mbeturina të higjenës, apo mbeturina ambulatore, të cilat mund të bashkohen me pjesën e mbeturinave komunale, si dhe kategori të tjera mbeturinash.



Figura 4 Përqindja e fraksioneve të mbeturinave në nivel Kombëtar  
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Mbeturinat e gjeneruara në Junik janë kryesisht mbeturina të amvisërive. Për më tepër, mbeturinat komerciale, të ngjashme me ato të amvisërisë janë pjesë e mbeturinave të gjeneruara komunale. Këto lloje të mbeturinave krijohen nga banorët e komunës si dhe nga ndërmarrjet e ndryshme dhe institucione të tilla si dyqane, restorante dhe zyret publike dhe private. Të dhënat mbi sasinë e mbeturinave të amvisërive dhe mbeturinave komerciale janë të pjesshme. Të dhënat e vetme dhe të besueshme mbi të cilat mund të bazohen vlerësimet e mbeturinave vijnë nga kompania e grumbullimit të mbeturinave që dërgon mbeturinat në deponinë e mbeturinave Sferk e Gashit në Komunën e Klinës ku është instaluar një peshore.

Në bazë të përvojës dhe praktikave, mbeturinat e amvisërive përbëjnë vetëm 70% deri në 75% të mbeturinave të amvisërive dhe komerciale së bashku. Përveç rreth 540 tonë të mbeturinave të amvisërive, pritet të gjenerohen rreth 230 tonë mbeturina komerciale duke e dërguar numrin e përgjithshëm të mbeturinave të prodhuara në 770 tonë për vit. Për pesë vitet e mbuluar nga Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave, gjenerimi vjetor i mbeturinave komunale supozohet se do të mbetet në këtë nivel.

Përveç mbeturinave shtëpiake dhe mbeturinave komerciale, në Junik gjenerohen sasi të mëdha të mbeturinave të ndërtimit dhe të rrënimit. Megjithatë të dhënat për sasinë e krijuara ende nuk janë mbledhur dhe të dhëna të besueshme për të bazuar vlerësimin nuk janë në dispozicion. Vëzhgimi i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit të hedhura në mënyrë të paligjshme në vende të ndryshme në

komunë, tregojnë megjithatë se shkalla e gjenerimit të mbeturinave është e konsiderueshme dhe mund të jetë më tepër se 1000 ton në vit.<sup>4</sup>

Përbërja e mbeturinave komerciale dhe atyre të amvisërisë nuk është përcaktuar në mënyrë të detajuar. Megjithatë, mund të supozohet se përbërja e mbeturinave në Junik nuk dallon në mënyrë të konsiderueshme nga mbeturinat e krijuara në zonat tjera të Kosovës. Në bazë të dhënave të paraqitura nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK, 2008) dhe një ushtrimi ekstensiv të klasifikimit të mbeturinave, të kryer në Junik, mund të paraqitet treguesi i mëposhtëm për përbërjen e mbeturinave të ngurta komunale.

Përbërja treguese e mbeturinave të ngurta komunale në Junik		
Ndarja e mbeturinave	Kosovë	Junik
<b>Organike (mbeturinat e kuzhinës dhe kopshtit)</b>	35.3%	35.8%
<b>Xhami</b>	21%	11.8%
<b>Druri</b>	11%	14.2%
<b>Plastika</b>	9.4%	9.4%
<b>Metalet</b>	9.3%	11.1%
<b>Tekstilet</b>	8.2%	13.5
<b>Letër dhe karton</b>	4.6%	4.1%
<b>Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake</b>	1.2%	0.1%
	100%	100%

Tabela 3 Treguesit e mbeturinave komunale në Junik

Burimi: [Komuna Junik]

Në krahasim me mbeturinat e përziera komunale nga amvisëritë dhe subjektet tjera të kombinuara, mbeturinat komerciale përmbajnë përqindje më të lartë të materialeve të paketimit dhe për këtë edhe kanë përqindje më të larta të letres, kartonit dhe plastikës. Nuk është bërë analiza e detajuar e përbërjes së mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimt në Junik, por vëzhgimet e bëra në deponitë ilegale tregojnë se pjesët më të mëdha janë mbeturinat e betonit dhe mbeturinat e blloqeve ndërtimore. Fraksionet e tjera të vërejtura përfshijnë drurin, plastikën, çimenton, asbestin dhe gipsin.

### 3.1.3 Trendi i prodhimit të mbeturinave në komunë

Bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, në nivel kombëtar, koeficienti i rritjes së popullsisë parashikohet të jetë 1.2%<sup>5</sup>. Në tabelën mëposhtë parashikohet një trend i rritjes së popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Juniks gjatë 10 viteve të ardhshme:

x		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Projeksioni i rritjes së popullsisë (1.2%)	nr.	6,084	6,157	6,231	6,306	6,381	6,458	6,535	6,614	6,693	6,774
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton) (1.2%)	% sipas rrymave	1,332	1,348	1,365	1,381	1,398	1,414	1,431	1,448	1,466	1,483

<sup>4</sup> Plani për menaxhimin e mbeturinave 2014 - 2019

<sup>5</sup> Agjësia e Statistikave të Kosovës 2015, Vlerësim Popullsisë e Kosovës 2015




Figura 5 Trendi i rritjes së popullsisës dhe sasisë së mbeturinave gjatë 10 viteve të ardhshme [Burimi: zhvilluar nga autori]

### 3.2 Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave

Në Komunën e Junikut shërbimi kryhet nga kompania private VB Tofaj. Shërbimi kryhet derë më derë në të gjitha ekonomitë familjare me shporta 120 litra, ndërsa në hapsirat publike janë kontenierët 1.1 m<sup>3</sup>. Konkretisht të 830 ekonomitë familjare në Junik janë të pajisur me shporta 120 litra. Ndërkohë në 12,000m<sup>2</sup> hapësira publike janë vendosur shporta nga 20 litra, të cilat zbrazen nga kompania. Në bizneset e qytetit janë të vendosur 102 kontenierë dhe 1 kontenier pranë institucioneve me kapacitet 1.1m<sup>3</sup>. Gjatë dy viteve të fundit numri i amvisërive (ekonomive familjare), bizneseve dhe institucioneve të shërbyera nuk ka ndryshuar, respektivisht 830 ekonomi familjare, 102 biznese dhe 8 institucione, siç tregohet në tabelën më poshtë:

Komuna	Klientë gjithsej në zonën kadastrale				Klientë të faturua = shërbyer				
	Qyteti/Fshat	Ekonomi familjare	Biznese	Institucione	Gjithësej	Ekonomi familjare	Biznese	Institucione	Gjithësej
Junik		1,148	121	8	1,277	830	102	8	940
Gjoçaj									
Jasiq									

Tabela 4 Situata e klientëve në Komunën e Junikut [Burimi: Kompani VB Tofaj]

Grumbullimi i mbeturinave në Komunën e Junikut, sipas të dhënave të mundësuar nga komuna, kryhet me kontenierë të përbashkët të vendosura në pika të ndryshme të qytetit si dhe grumbullim derë më derë, ku të 830 amviseritë të cilat janë në sistem janë të pajisur me kontenierë 120litra. Në tabelën më poshtë tregohet numri i kontenierëve i përcaktuar për secilën kategori të konsumatorëve sipas kapacitetit përkatës, 1.1m<sup>3</sup> dhe 120 litra.


Nr.	Kategoria e konsumatorëve	Nr. i kontenierëve 120 LITRA/1.1m <sup>3</sup>
1	Amvisëri	830 – 120 litra
2	Biznese	102 – 1.1m <sup>3</sup>
3	Institucione	

Tabela 5 Infrastruktura me kontenierë për grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Junikut  
[Burimi: Kompania KRM VB Tofaj]

Në figurëm më poshtë jepet infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave në komunën e Junikut:

### Grumbullimi Derë më derë në të gjitha ekonomitë familjare që janë pjesë e sistemit me shporta 120 litra – 830 kontenierë të shpërndarë në ekonomi familjare

#### Në pika kolektive (kontenier 1.1m<sup>3</sup>)



#### Në biznese dhe institucione (kontenier 1.1m<sup>3</sup>)



Pas lidhjes së kontratës me komunën, kompania në vitin 2013 ka prokuruar një automjet të dorës së dytë për mbledhjen e mbeturinave me mbushje nga prapa me anë të cilit shërbimet për grumbullimin e mbeturinave ofrohen dy herë në muaj. Edhe pse automjeti është i dorës së dytë (i prodhuar në vitin 2006), automjeti është në gjendje të mirë dhe pritet të përdoret për disa vite në të ardhmen. Numri i punëtorëve të angazhuar për kryerjen e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave është 4, dhe kompania private përdor aktualisht 1 mjet teknologjik për kryerjen e shërbimit në territorin e Junikut. Gjatë vitit 2018 mjeti teknologjik ka kryer grumbullimin e mbeturinave 1 herë në muaj, ndërsa në vitin 2019 frekuenca e grumbullimit është rritur me 1 herë në javë, 4 herë në muaj. Komuna e Junikut i deponon mbeturinat në deponinë rajonale ne Pejë dhe nuk i dërgon ato në stacion transferi. Pagesa për në deponi është 5euro/m<sup>3</sup>.

Siç mund ta shohim edhe në hartën më poshtë komuna e Junikut, pothuajse e ofron shërbimin në të gjithë territorin e saj, të vlerësuar nga raporti i AMMK:

**KOMUNA E JUNIKUT**  
Shtirja e shërbimit të menxhimit të mbeturinave





Figura 6 Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Junikut  
[Burimi: GIZ, AMMK]

Përveç grumbullimit të mbeturinave, kompania ofron shërbimin e spastrimit të rrugëve dhe parqeve. Kompania ka të punësuar 2 persona të cilët punojnë me orar të plotë në sektorin e menxhimit të mbeturinave. Në ditët e grumbullimit ata shërbejnë si ekuipazhi i automjetit të grumbullimit të mbeturinave, ndërsa gjatë ditëve të tjera ata pastrojnë rrugët dhe parqet dhe zbrazin shportat publike të mbeturinave. Një shofer i është shtuar stafit për menxhimin e mbeturinave gjatë ditëve të grumbullimit

Pasi që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave iu ofrohen vetëm një pjese të gjeneruesve të mbeturinave, një pjesë e vogël e ekonomive familjare dhe 40% e ndërmarrjeve private menaxhojnë mbeturinat e tyre në mënyrë vetanake. Këta gjenerues të mbeturinave i deponojnë mbeturinat e tyre në vende të ndryshme ilegale, të cilat mund të gjenden në periferi të komunës. Është vlerësuar se çdo

vit rreth 440 tonë të mbeturinave të amvisërisë dhe mbeturinave komerciale dhe praktikisht të gjitha mbeturinat e ndërtimit dhe demolimit përfundojnë në këto vende, ku një pjesë e tyre edhe digjen.

### **3.3 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave**

#### **3.3.1 Riciklimi dhe kompostimi**

Nuk raportohen aktivitete formale të riciklimit të mbeturinave. Ato grumbullohen të përziera dhe transportohen për në deponi regjionale të Pejës (Sferkë).

Sot tregu i mbeturinave të riciklueshme në Kosovë është në hapat e para të zhvillimit të tij. Megjithatë, në shumë komuna kanë filluar aktivitetin kompani të ndryshme, të cilat grumbullojnë, paketojnë ose përpunojnë fraksione të ndryshme të mbeturinave të riciklueshme, si letrën, plastikë, alumini etj. Furnizuesi kryesor të këtyre kompanive është sektori informal. Ky sektor vepron mbi baza individuale dhe në kushte aspak higjieno – sanitare, duke grumbulluar mbeturinat e riciklueshme, kryesisht në konteinerët publik apo në deponitë ilegale. Kompanitë private grumbullojnë lëndën e parë nga sektori informal, kundrejt një çmimi të caktuar për cilin fraksion:

- i) 17-23 cent/kg plastika;
- ii) 3-6.5 cent/kg letra dhe kartoni;
- iii) 80 cent/kg alumini. Zakonisht sasia mesatare e fraksioneve të grumbulluara nga këto kompani varion nga 8-10 ton mbeturina për secilin fraksion.

Kryesisht këto kompani kryejnë disa procese në stabilimentet e tyre:

- i) Në rastin e plastikës ata mund ta kompresojnë dhe më pas e shesin, ose mund ta përpunojnë në formën e petezave dhe e shesin si lëndë të parë tek sektori i ambalazheve;
- ii) Në rastin e letrës apo të kartonit, kryesisht grumbullohet dhe presohet për t'u shitur në treg. Pjesa më e madhe e produkteve të këtyre kompanive furnizon tregun e brendshëm.

Me përjashtimin të rikuperimit të disa fraksioneve të mbeturinave të riciklueshme, ndarja, kompostimi dhe riciklimi i mbeturinave momentalisht nuk është duke u bërë në Junik.

#### **3.3.2 Deponia**

Komuna e Junikut ka ndarë një lokacion të veçantë me vendim të KK për hedhjen e mbeturinave inerte. Lokacioni është në vendin e quajtur Shkoza dhe aty qytetarët e Junikut mund t'i hedhin mbeturinat e ngurta.

Në territorin e Komunës të Junikut është caktuar një vendndodhje e veçantë, me vendim të KK, për hedhjen e mbeturinave inerte. Ky lokacion është quajtur Shkoza dhe tanimë është pajisur edhe me kamera vëzhgimi që të evitohen abuzimet nga ana e qytetarëve të cilët mund ti sjellin vetë mbeturinat e tyre të ngurta aty.




Figura 7 Deponi legale për mbeturinat nga ndërtim demolimi në Komunën Junik  
[Burimi: Autori]

Sasia e mbeturinave të grumbulluara bartet në lokacionin e deponisë të Pejës (Sferkë) Viti i ndërtimit: 2001 (financuar nga COPI).

- Madhësia: 3,6 ha
- Zona me lajner të bazës: 3 ha
- Lloji i lajnerit të bazës: Gjeomembranë (HDPE)
- Kapaciteti total: 1,500,000 m<sup>3</sup>

Deponia u shërben komunave të: Pejës, Deçanit, Klinës dhe Junikut. Gjendja dhe menaxhimi aktual nuk është i kënaqshëm. Procedurat operative të deponisë janë shumë të thjeshta, pa menaxhim të duhur të ujit, trajtim të mbeturinave të ngurta komunale (të përziara), kompaktim të duhur, planifikim apo reduktim të zonës aktive (të hapur) apo parandalim të zjarrit. Nuk dihet as lloji dhe sasia e kimikateve që hidhen në deponi. Për më tepër, për shkak të mosfunksionimit të një stacioni të pompimit për riqarkullim të ujërave të ndotur ujrave të shiut rrjedhin në mënyrë të pakontrolluar nga zona e deponisë, nga drenazhet dhe daljet, duke i ndotur kështu shumë ujërat sipërfaqësore. Deponia tashmë ka arritur fundin e kapacitetit të deponimit, kështu që ka nevojë urgjente për intervenim<sup>6</sup>.

<sup>6</sup> Burimi: Studimi i parafizibilitetit për zbatimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave duke përfshirë: mbledhjen, transportimin, trajtimin dhe deponimin në rajonin e Pejës, ASA, 2014

### 3.3.3 Pastrimi i deponive ilegale në Komunë e e Junikut

Sipas Ligji për Mbeturinat, komunat janë të detyruara që të nxjerrin një regjistër të deponive ilegale në territorin e tyre, brenda një periudhe njëvjeçare, siç përcaktohet në nenin 81. Kjo detyrë duhet të kryhet nga inspektorët komunalë të mjedisit (neni 62), të cilët shpesh herë bashkëpunojnë me stafin përkatës të Ndërmarrjeve Publike. Ushtrimi i zhvilluar në Komunën e Junikut për evidentimin e deponive ilegale, me mbështetjen e GIZ, ka evidentuar 11 deponi të tilla. Ekipi identifikues në terren ka fotografuar pikat ilegale, ka shënuar koordinata përkatëse dhe ka përcaktuar vëllimin përkatës të tyre si dhe ka përcaktuar fraksionet e mbeturinave që gjendeshin në deponitë ilegale. Në hartën më poshtë tregohet shpërndarja e deponive ilegale të evidentuara në Komunën e Junikut:




Figura 8 Deponitë ilegale në Komunën Junik  
[Burimi: GIZ, AMMK]

Sipas këtyre studimeve rezulton se në Komunën e Junikut ka 11 deponi ilegale. Ato janë ndarë në tre kategori:

- i) sipas llojit të mbeturinave;
- ii) sipas sipërfaqes;
- iii) sipas numrit të qeseve të mbeturinave që kanë.

Bazuar në këtë klasifikim në grafikët më poshtë paraqitet një përmbledhje për të gjithë deponitë sipas kategorive:




Figura 9 Lloji i mbeturinave në deponitë ilegale në territorin e Komunës  
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 10 Sipërfaqja e deponive ilegale në territorin e Komunës  
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 11 Sasia e qeseve në deponitë ilegale  
[Burimi: zhvilluar nga autori]


Pas identifikimit të të gjitha deponive ilegale në territorin e Komunës së Junikut, aktualisht kjo komunë nuk ka më deponi ilegale në territorin e saj, pasi i ka pastruar të të gjitha, dhe vazhdon përpjekjet për mos rikrijimin e tyre.

#### IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

##### 4.1 Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Në llogaritjen e plotë të koston së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave Komuna duhet të sigurojë të gjithë zërat e nevojshëm për tre shërbimet kryesore të sistemit tëmenaxhimit të mbeturinave:

- i) grumbullimi dhe transporti i mbeturinave;
- ii) deponia;
- iii) autoparku, ashtu siç janë paraqitur në diagramën më poshtë:






Figura 12 Kosto e plotë e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave  
[Burimi: metodologjia e GIZ, përshtatur nga autori]

Në rastin e Komunës së Junikut, Komuna nuk deklaron të ketë llogaritur një kosto të plotë të shërbimit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave. Komuna ndonëse nuk e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave në sajë të detyrimeve që ja përcakton ligji për menaxhimin e mbeturinave, ka për detyrë të llogarisë dhe të njohë koston e plotë të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave sipas zërave të përcaktuar më lart. Në këtë mënyrë komuna arrin të kuptojë realisht kostot specifike të të gjitha shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, dhe mund të përcaktojë qartësisht nivelin e tarifave të pastrimit me synim mbulimin e plotë të koston. Nga të dhënat e mundësuar nga kompania jepet një kosto vjetore për shërbime grumbullimit dhe transportit të mbeturinave prej 18,096 Euro, por nuk specifikohen linjat e buxhetit që janë marrë në konsideratë.

#### 4.2 Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Autoriteti i vetëm për caktimin e tarifave të shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave pas shuarjes së veprimtarisë së ZRRUM-it (Zyra Rregullative për Ujin dhe Mbeturinën), sipas bazës ligjore janë Komunitetet e Republikës së Kosovës.

Komuna e Junikut ka këtë nivel të tarifave sipas kategorive të konsumatorëve që janë në sistem dhe kanë një kontratë me kompaninë që kryen shërbimin në territorin e komunës:

Kategoritë e konsumatorëve	Tarifa e pastrimit €/muaj
Amvisëritë	5
Bizneset kategoria I	7.3
Bizneset Kategoria II	17.2
Institucionet	6

Tabela 6 Niveli i tarifave të pastrimit sipas kategorive të konsumatorëve  
[Burimi: Kompania VB Tofaj“]

Komuna e Junikut e paguan kompaninë për mbledhjen e mbeturinave nga të gjitha 8 institucionet në Junik, si dhe për pastrimin e rrugëve dhe zbrazjen e shportave publike të mbeturinave. Në bazë të kontratës janë bërë pagesat e mëposhtme:

- Zbrazja e një kontenierë prej 1,100 litrave: 6,50 €
- Zbrazja e një kontenierë prej 120 litrave: 2,50 €
- Zbrazja e një shporte publike të mbeturinave prej 20 litrave: 1,00 €
- Pastrimi i rrugës 8000 m<sup>2</sup>: 320,00 €

Ndërkohë në vitin 2018, nga konsumatorët të cilët janë fatuar, përqindja e inkasimit ishte 98%, dhe nga të hyrat nga tarifa, bazuar në të dhënat e deklaruara nga komuna, buxheti për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave mbulohet plotësisht nga të ardhurat. Ndërkohë për vitin 2019 ky nivel i inkasimit ka qënë në masën 72%. Në këto kushte komuna duhet të bëjë llogaritjen e plotë të koston, duke përdorur modelin e hartuar nga GIZ për të kuptuar realisht koston e plotë të shërbimit dhe për të planifikuar saktë nivelin e tarifave, për të siguruar mbulimin e plotë të koston së shërbimit. Aktualisht kompania që ofron shërbimin në Komunën e Junik nuk ka përfituar grante kapitale deri tani, dhe nuk ka borxhe ndaj ndonjë institucioni.

## V. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

### 5.1 Objektivat dhe targetat e Strategjise dhe Planit Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave

Sipas Strategjisë dhe Planit Nacional të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave qëllimi i kryesor është krijimi i një kornize masash, të cilat do të synojnë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që krijohen në burim, zvogëlimin e sasisë së tyre që shkojnë në deponi dhe zhvillimin e një infrastrukture për ngritjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Gjatë periudhës kohore 10 vjeçare 2013-2022 të zbatimit të saj, strategjia ka vendosur tre periudha kohore të rëndësishme (2015 – 2019 – 2022) dhe targetat përkatëse:

- Grumbullimi i mbeturinave komunale



- Ndarja në fraksione e mbeturinave komunale



iii. Trajtimi i mbeturinave



iv. Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi



v. Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale



Siç mund ta shohim, strategjia synon rritjen e shkallës të mbulimit me shërbim, rritjen e përqindjes të ndarjes dhe grumbullimin e ndarë të mbeturinave, rritjen e përqindjes të trajtimit të mbeturinave, si dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave që shkojnë në deponi dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave të biodegradueshme që grumbullohen me ato komunale. Trajtimi i mbeturinave në deponitë mbetet një nga mënyrat përfundimtare të trajtimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës deri në fund të dhjetëvjeçarit të strategjisë (2022).

## 5.2 Objektivat e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave

Në Ligjin nr.04/I-060 "Për menaxhimin e mbeturinave ", 2012, i amenduar, përcaktohet detyrimi për hartimin dhe zbatimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave si dhe rregulloreve përkatëse për të gjithë komponentët e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave nga Komuna. Konkretisht komuna ka si detyrim ligjor:

1. Hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional;
2. Zbatimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave;
3. Hartimin e rregulloreve me përgjegjësitë dhe detyrimet për organizimin dhe ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre;
4. Krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi për informimin e publikut dhe raportimin mbi punën e bërë dhe përgatitjen e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
5. Identifikimin e deponive të egra në territorin e tyre dhe zhvillimin e projekteve për rehabilitimin e tyre;
6. Përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
7. Aplikimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licensuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në territorin e tyre;
8. Mbikqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve të mjedisit në komunë;
9. Bashkëpunimin ndërvendor midis dy ose më shumë komunave për menaxhimin e mbeturinave;
10. Përcaktimin e sasisë dhe llojit të mbeturinave që pritet të krijohen duke identifikuar llojin dhe origjinën e tyre;
11. Hartimin e skemave dhe programeve për mbledhjen e mbeturinave (nga amvisëritë, bizneset dhe industria);
12. Hartimin e programeve për grumbullimin e ndarë, sidomos grumbullimin e rrymave të rrezikshme;
13. Hartimin e propozimeve teknike të duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave;
14. Hartimin e programeve për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave;
15. Vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për aktivitetet/projektet e planifikuara për menaxhimin e mbeturinave dhe identifikimin e fondeve për zbatimin e tyre.

### 5.3 Vizioni i planit komunal

Gjatë procesit të hartimit të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave, grupi i punës nga Komuna Junik, përfaqësues të Kompanisë Private për Mbeturina “ VB Tofaj”, grupi i punës i EcoDES Studio dhe GIZ Kosovo zhvilloi një proces analizimi dhe diskutimesh për të formëzuar vizionin e planit.



Figura 13 Procesi i diskutimeve me grupin e punës për hartimin e planit

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave, prioriteteve të përgjithshme dhe konkrete si dhe pritshmërive lokale për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, realiteteve dhe sfidave, dhe dëshirës e bindjes për ndryshim, u ra dakord që vizioni i komunës të formëzohet si më poshtë:

***“Një mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i mbrojtur mirë mbështet një shoqëri dhe ekonomi të qëndrueshme”.***

Nga diskutimet dhe takimet e zhvilluara me përfaqësues të Komunës së Junikut, në sajë të analizës të gjendjes ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, së bashku me komunën ramë dakort për këto objektiva të planit:




Figura 14 Objektivat e planit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën Junik

[Burimi: zhvilluar nga autori]

#### 5.4 Objekti i Planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues<sup>7</sup>, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbeturinave komunale për të cilën Komuna e Junikut është drejtëpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse. Në varësi nga **ekspozimi i rrezikshmërisë** mbeturinat, sipas këtij ligji kategorizohen si: i) mbeturina inerte; ii) mbeturina të parrezikshme; iii) mbeturina të rrezikshme; dhe në varësi të **llojit mbeturinat** klasifikohen në: i) Mbeturina komunale; ii) mbeturina komerciale; iii) mbeturina industriale; iv) mbeturina medicinale.

Në lidhje me **burimet e gjenerimit të mbeturinave**, mbeturinat komunale ndahen në dy rryma mbeturinash, sipas burimit të origjinës: (MA) mbeturinat e prodhuara nga amvisëritë; (MB) mbeturinat e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbeturinave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbeturinave urbane.

<sup>7</sup>Ligjin nr. 04/I-060 "Për menaxhimin e mbeturinave", 2012, Kreu III "Llojet – Klasifikimi dhe karakterizimi i mbeturinave", neni 6 "Llojet e mbeturinave"

Plani do të fokusohet drejtëpërdrejtë në dhënien e zgjidhjes për mbeturinat e parrezikshme nga amvisëritë dhe bizneset e vogla komerciale, të cilat prodhojnë mbeturina komunale (inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre). Në lidhje me kategoritë e tjera të mbeturinave, plani do të japë disa konsiderata të përgjithshme, të cilat duhet t'i ketë parasysh për të siguruar që ato të mos hidhen nga gjeneruesit e tyre në kontenerët kolektivë.

Në diagramën më poshtë jepët skema e mbeturinave komunale, përgjegjësi e komunës për t'u menaxhuar:




Figura 15 Skema e rrymës të mbeturinave komunale

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Ky ligj gjithashtu, në *Kreun VI të tij "Përgjegjësitë dhe Detyrimet për Menaxhimin e mbeturinave"* përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet për aktorët e mëposhtëm të cilët janë pjesë e ciklit të menaxhimit të mbeturinave:

- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e zotëruesit të mbeturinave** – zotëruesi i mbeturinave është personi i licensuar përgjegjës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit dhe importuesit e produkteve** - Prodhuesi i mbeturinave dhe importuesi i mallrave me potencial për krijimin e mbeturinave janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga produktet e tij;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit të mbeturinave** – përgjegjës për menaxhimin e plotë të mbeturinave që prodhon ose dorëzimin e tyre për trajtimin dhe deponim tek personat e licensuar;


- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e transportuesit të mbeturinave** – ata duhet të jenë të licensuar për transportin e mbeturinave, dhe duhet të kryejnë këtë proces bazuar në kushtet e licensës për transport;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave** – këta operatorë duhet të jenë të licensuar për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit në deponi të mbeturinave** - këta operatorë duhet të jenë të licensuar për deponimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës.

## VI. HARTIMI DHE PERSHKRIMI I MASAVE PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT

Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave bazohet në 7 objektiva kryesorë, të cilët do të detajohen më pas në aktivitete konkrete sipas afateve kohore dhe përgjegjësi përkatëse. Bazuar në analizën e kryer të gjendjes ekzistuese dhe planeve që ka komuna në të ardhmen, në plan propozohet ndarja e komunës në një zonë funksionale të ofrimit të shërbimit, atë të lagjes Juniku i Ri. Zonat e tjera janë të pabanuara si rrjedhojë e emigrimit të lartë në ato zona.

### 6.1 Aktivitetet kryesore për të përmbushur OBJEKTIVIN I të planit

**Si objektivi i parë, Komuna e Junikut ka hartimin e një kuadri ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e ndërmarrjes publike-komunale për ofrimin e shërbimeve komunale.** Ky kuadër do të konsistojë në konsolidimin e strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave si një hap kryesor dhe vendimtar për mbarëvajtjen e krijimit të kompanisë, duke filluar që në vitin e parë të zbatimit të planit (**viti 2020**), bazuar në 5 aktivitetet kryesore si në diagramën më poshtë.



Pagat e punëtorëve të ndërmarrjes publike komunale			
Bordi i Drejtorëve	Paga	Gjithsej në muaj	Gjithsej në vit
5	550€	2,750€	33,000.00€
Drejtori i Përgjithshëm	700€	700€	8,400.00€
Drejtori Financiar	600€	600€	7,200.00€
Punëtorë Administrativ	Paga	Gjithsej në muaj	Gjithsej në vit
3	450€	1,350€	16,200.00€
Punëtorët Teknik	Paga	Gjithsej në muaj	Gjithsej në vit
12	350€	4,200€	50,400.00€
<b>Totali</b>	<b>2,650€</b>	<b>9,600€</b>	<b>115,200.00€</b>

Tabela 7 Kosto e operative e personelit për kompaninë komunale "Moronica"

[Burimi: Kompania Junik]

Kjo kompani, e cila do të quhet Moronica do të synojë që të ketë pjesë të punës së saj të përditshme shërbime të tjera komunale, si menaxhimin e mbeturinave, shërbimin e ujit dhe menaxhimin e hapsirave publike.

### Hapat për mbarëvajtjen e kompanisë

#### Caktimi i përgjegjësi

Duhet të caktohet pala përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, gjë që do të sigurojë zbatimin e planit të menaxhimit të mbeturinave dhe funksionimin e kompanisë.

#### Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave afatgjatë

Eliminimi i gjenerimit të mbeturinave duhet të jetë përparësia kryesore, me pas fokusi duhet të mbetet tek ripërdorimi dhe riciklimi.

Llogaritja e plotë e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

Identifikimi i të gjithë klientëve në territor dhe përcaktimi i tarifës së pastrimit bazuar në koston e plotë të shërbimit

Mbulimi i territorit të komunës me shërbim dhe futja në sistem e të gjithë klientëve për të paguar tarifën e pastrimit

Fushata intensive për inkasimin e tarofës për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të kompanisë

#### Vlerësimi i saktë i fraksioneve të mbeturinave në komunë

Parashikimi llojeve dhe përqindjet e mbeturinave që do të prodhohen në krahasim me të dhënat ekzistuese.

#### Përcaktimi i objektivave të riciklimit

#### Përshkrimi i metodave të riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave

#### Identifikimi i vendeve ku do bëhet deponimi i mbeturinave

#### Monitorimi i vazhdueshëm

#### Rishikimi i planit në afate të caktuara